



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.12

29 shkurt

2012

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr. 7/2012 datë 9.2.2012	Për ratifikimin e vendimeve të Këshillit Administrativ dhe të Bordit Drejtues të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB), rezoluta nr.1532 “Propozim i Këshillit Administrativ mbi rritjen e kapitalit të Bankës” (shtojca A), rezoluta nr.386 “Vendim mbi rritjen e kapitalit të Bankës” (shtojca B), si dhe dokumenti “Letra e Guvernatorit të Bankës, datë 8.4.2011, mbi fazat e rritjes së kapitalit”	513
Ligj nr. 8/2012 datë 9.2.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të <i>bypass-eve</i> të rrugës së Fierit dhe Vlorës	517
Ligj nr. 9/2012 datë 9.2.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim Abu Dhabi për financimin e projektit të rrugës Tiranë-Elbasan...	528
Ligj nr. 10/2012 datë 9.2.2012	Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	537
Ligj nr. 11/2012 datë 9.2.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar	540

LIGJ
Nr. 7/2012

PËR RATIFIKIMIN E VENDIMEVE TË KËSHILLIT ADMINISTRATIV DHE TË BORDIT DREJTUES TË BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EUROPËS (CEB), REZOLUTA NR.1532 “PROPOZIM I KËSHILLIT ADMINISTRATIV MBI RITJEN E KAPITALIT TË BANKËS” (SHTOJCA A), REZOLUTA NR.386 “VENDIM MBI RITJEN E KAPITALIT TË BANKËS” (SHTOJCA B), SI DHE DOKUMENTI “LETRA E GUVERNATORIT TË BANKËS, DATË 8.4.2011, MBI FAZAT E RITJES SË KAPITALIT”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohen vendimet e Këshillit Administrativ dhe të Bordit Drejtues të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB), rezoluta nr.1532 “Propozimi i Këshillit Administrativ mbi rritjen e kapitalit të Bankës” (shtojca A), dhe rezoluta nr.386 “Vendim mbi rritjen e kapitalit të Bankës” (shtojca B), si dhe dokumenti “Letra e Guvernatorit të Bankës, datë 8.4.2011, mbi fazat e rritjes së kapitalit”.

Neni 2

Rezolutat e mëvonshme, që nuk kanë të bëjnë me marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Republika e Shqipërisë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.2.2012

Shpallur me dekretin nr.7287, datë 21.2.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

CEB
Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës
Guvernatori
Paris, 8 prill 2011

Të nderuar Ambasadorë,

Në vijim të mbledhjes së Bordit tuaj Drejtues të datës 4 shkurt 2011, mendoj se është e rëndësishme t’ju dërgoj këtë letër që shpjegon fazat kryesore të procesit të rritjes së kapitalit. Në fakt, në lidhje me rritjen e mëparshme të kapitalit, procesi përfshin dy faza të ndryshme.

Faza e parë përbëhet nga aprovimi i pranimit të rritjes së gjashtë në kapitalin e CEB-it, së bashku me kushtet për zbatimin e tij, siç përcaktohet nga Rezoluta 386 (2011) mbi rekomandimin nga Këshilli Administrativ (Rezoluta 1532 (2011)). Nëse të gjitha shtetet anëtare konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në këtë rritje kapitali, kapitali i nënshkruar do të rritet nga 3.3 në 5.5 miliardë euro. Rritja do të shoqërohet nga përfshirja e rezervave që vlejnë 246 milionë euro në kapitalin e paguar, pa pagesë reale nga shtetet anëtare.



Një fazë e dytë kryesore duhet tashmë të merret përsipër, që përbëhet nga çdo shtet anëtar, i cili konfirmon angazhimin e tij ndaj nënshkrimit, pa të cilin Rezoluta 386 (2011) do të mbetet pa fuqi në deklaratat financiare të Bankës. Ky konfirmim është thelbësor, në mënyrë që rritja e kapitalit të hyjë në fuqi sa më parë që të jetë e mundur që prej 31 dhjetorit 2011, duke pasur parasysh se kufiri minimal që duhet të arrihet është 67 % e certifikatave të ofruara pjesëmarrëse.

Me qëllim lehtësimin e masave të nevojshme për konfirmimin e pjesëmarrjes së vendit tuaj, në përputhje me procedurat tuaja kombëtare (buxhetimi, ratifikimi parlamentar, nëse është e nevojshme etj.), kam kënaqësinë t'ju dërgoj bashkëlidhur:

- një model të letrës zyrtare që do të nënshkruhet nga autoriteti kompetent i vendit tuaj dhe t'i kthehet Bankës;

- tabelën e rritjes së gjashtë të kapitalit, që tregon për vendin tuaj, shumën e përgjithshme që do të nënshkruhet (kolona 7), si dhe shumën që do të transferohet nga rezerva e përgjithshme në kapitalin e paguar (kolona 5), ku të dyja duhet të përcaktohen në letrën zyrtare.

Së fundi, do të dëshiroja t'ju kujtoja se konfirmimi nga autoritetet tuaja kombëtare është i një rëndësie të madhe. Kjo është e nevojshme për zbatimin e rritjes së gjashtë në kapitalin e institucionit tonë. Kjo rritje do t'i japë mundësinë Bankës të forcojë qëndrueshmërinë e saj financiare dhe të konsolidojë mjetet e saj të veprimit, kryesisht në favor të shteteve të saj anëtare më pak të favorizuara.

Me respekt,

Firma
Raphaël ALOMAR

Në vëmendje të: Anëtarëve të Këshillit Administrativ

Bashkëlidhur: - letra e nënshkrimit;

- tabela e rritjes së gjashtë të kapitalit.

[Logoja e vendit]

Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës

Z. Guvernator

55, Avenue Kléber

75016 Paris

[datë] 2011

I nderuar z. Guvernator,

Pas një propozimi nga Këshilli i Administrimit (Rezoluta 1532 (2011)), më 28 janar 2011, Bordi Drejtues i Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës vendosi me anë të Rezolutës së tij 386 (2011) më 4 shkurt 2011, të mundësojë kapitalin e nënshkruar të Bankës nga 3 303 450 000 euro në 5 503 450 000 euro.

Kjo Rezolutë parashikon që kjo rritje në kapital të hyjë në fuqi nga data 31 dhjetor 2011, me kusht që deri në atë datë, të paktën 67 % e aksioneve të ofruara të jetë nënshkruar nga shtetet anëtare, dhe që rritja të përfundojë më 30 qershor 2012.

Rezoluta 386 (2011) fton [emri i vendit] të nënshkruajë certifikatat pjesëmarrëse për një shumë prej [shuma] euro nga të cilat [shuma] euro do të transferohet nga rezerva e përgjithshme dhe do të përfshihet në kapitalin e kërkuar. Unë konfirmoj se për [emri i vendit], të gjitha kushtet janë përmbushur për nënshkrimin e shumës së lartpërmendur. Theksoj se regjistrimi i këtyre certifikatave të reja do të realizohet sipas dispozitave të përcaktuara në Rezolutën 386 (2011) dhe në asnjë rast, nuk do të përfshijë detyrimin e pagesës së menjëhershme nga vendi im.

Me respekt,

[Firma]

NDARJA SIPAS VENDEVE TË RRTJES SË 6-TË TË KAPITALIT

Vendet anëtare	GJENDJA SIPAS DATËS 31.12.2010				RRITJA E PROPOZUAR E KAPITALIT			GJENDJA PAS RRTJES SË KAPITALIT				
	Kapitali i nënshkruar		Kapitali i kërkuar					Kapitali i nënshkruar		Kapitali i kërkuar		
(Në mijë euro)	Sasia	% e të drejtave të votimit	Sasia	% 4=(3/1)	Kapital i kërkuar (përfshirja e rezervave)	Kapital i pakërkuar 6= (7-5)	Totali 7= (5+6)	Sasia 8= (1+7)	Në % të të drejtave të votimit	Sasia 10 = (3+5)	Në % 11= (10/8)	Kapitali i pakërkuar 12=(8-10)
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Shqipëria	8 034	0,243%	887	11, 041%	599	4 752	5 351	12 385	0, 243 %	1 486	11, 102 %	11 899
Belgjika	98 634	2,986%	10 888	11, 039 %	7 350	58 337	65 687	164 321	2, 986 %	18 238	11, 099 %	146 083
Bosnja, Hercegovina	5 816	0,176 %	642	11, 039 %	433	3 440	3 873	9 689	0, 176 %	1 075	11, 095 %	8 614
Bullgaria	37 491	1, 135 %	4 139	11, 040 %	2 794	22 174	24 968	62 459	1, 135 %	6 933	11, 100 %	55 526
Kroacia	12 831	0,388 %	1 417	11, 044 %	956	7 589	8 545	21 376	0, 388 %	2 373	11, 101 %	19 003
Qipro	11 934	0,361 %	1 317	11, 036 %	889	7 059	7 948	19 882	0, 361 %	2 206	11, 095 %	17 676
Republika Çeke	25 833	0,782 %	2 852	11, 040 %	1 925	15 279	17 204	43 037	0, 782 %	4 777	11, 100 %	38 260
Danimarka	53 823	1, 629%	5 944	11, 044 %	4 011	31 833	35 844	89 667	1, 629 %	9 955	11, 102 %	79 712
Estonia	7 637	0,231%	843	11, 038 %	569	4 517	5 086	12 723	0, 231 %	1 412	11, 098 %	11 311
Finlanda	41 889	1, 268%	4 625	11, 041 %	3 122	24 775	27 897	69 786	1, 268 %	7 747	11, 101 %	62 039
Franca	549 692	16, 640%	60 692	11, 041 %	40 964	325 114	366 078	915 770	16, 640 %	101 656	11, 101 %	814 114
Gjeorgjia	5 928	0, 179%	654	11, 032 %	442	3 506	3 948	9 876	0, 179 %	1 096	11, 098 %	8 780
Gjermania	549 692	16, 640 %	60 692	11, 041 %	40 964	325 114	366 078	915 770	16, 640 %	101 656	11, 101 %	814 114
Greqia	98 634	2, 986%	10 888	11, 039 %	7 350	58 337	65 687	164 321	2, 986 %	18 238	11, 099 %	146 083
Vatikani	82	0, 002 %	24	29, 268 %	6	49	55	137	0, 002 %	30	11, 898 %	107
Hungaria	26 884	0,814%	2 968	11, 040 %	2 004	15 900	17 904	44 788	0, 814 %	4 972	11, 101 %	39 816
Islanda	6 089	0, 184 %	672	11, 036 %	454	3 601	4 055	10 144	0, 184 %	1 126	11, 100 %	9 018
Irlanda	28 998	0, 878 %	3 201	11, 039 %	2 161	17 151	19 312	48 310	0, 878 %	5 362	11, 099 %	42 948
Italia	549 692	16, 640%	60 692	11, 041 %	40 964	325 114	366 078	915 770	16, 640 %	101 656	11, 101 %	814 114
Letonia	7 688	0, 233%	848	11, 030 %	573	4 547	5 120	12 808	0, 233 %	1 421	11, 095 %	11 387
Lishtenshajni	2 921	0, 088%	547	18, 726 %	218	1 727	1 945	4 866	0, 088 %	765	15, 721 %	4 101
Lituanian	7 556	0, 229%	834	11, 038 %	563	4 469	5 032	12 588	0, 229 %	1 397	11, 098 %	11 191
Luksemburgu	20 849	0, 631 %	2 302	11, 041 %	1 554	12 331	13 885	34 734	0, 631 %	3 856	11, 102 %	30 878
Malta	6 089	0, 184 %	672	11, 036 %	454	3 601	4 055	10 144	0, 184 %	1 126	11, 100 %	9 018
Moldavia	3 294	0, 100 %	364	11, 050 %	246	1 948	2 194	5 488	0, 100 %	610	11, 115 %	4 878
Mali i Zi	3 952	0, 120 %	436	11, 032 %	295	2 337	2 632	6 584	0, 120 %	731	11, 103 %	5 853
Holanda	119 338	3, 613 %	13 177	11, 042 %	8 893	70 582	79 475	198 813	3, 613 %	22 070	11, 101 %	176 743
Norvegjia	41 889	1, 268 %	4 625	11, 041 %	3 122	24 775	27 897	69 786	1, 268 %	7 747	11, 101 %	62 039



Polonia	76 988	2, 331 %	8 500	11, 041 %	5 737	45 535	51 272	128 260	2, 331 %	14 237	11, 100 %	114 023
Portugalia	83 538	2, 529 %	9 223	11, 040 %	6 225	49 409	55 634	139 172	2, 529 %	15 448	11, 100 %	123 724
Rumania	35 963	1, 089 %	3 970	11, 039 %	2 680	21 271	23 951	59 914	1, 089 %	6 650	11, 099 %	53 264
San Marino	2 921	0, 088 %	443	15, 166 %	218	1 728	1 946	4 867	0, 088 %	661	13, 581 %	4 206
Serbia	15 511	0, 470 %	1 712	11, 037 %	1 156	9 174	10 330	25 841	0, 470 %	2 868	11, 099 %	22 973
Republika Sllovake	11 380	0, 344 %	1 257	11, 046 %	848	6 731	7 579	18 959	0, 344 %	2 105	11, 103 %	16 854
Sllovenia	7 380	0, 223 %	815	11, 043 %	550	4 365	4 915	12 295	0, 223 %	1 365	11, 102 %	10 930
Spanja	358 504	10, 852 %	39 582	11, 041 %	26 717	212 036	238 753	597 257	10, 852 %	66 299	11, 101 %	530 958
Suedia	83 538	2, 529 %	9 223	11, 040 %	6 225	49 409	55 634	139 172	2, 529 %	15 448	11, 100 %	123 724
Zvicra	53 824	1, 629 %	10 595	19, 685 %	4 011	31 834	35 845	89 669	1, 629 %	14 606	16, 289 %	75 063
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	7 637	0, 231 %	843	11, 038 %	569	4 517	5 086	12 723	0, 231 %	1 412	11, 098 %	11 311
Turqia	233 077	7, 056 %	25 733	11, 041 %	17 369	137 853	155 222	388 299	7, 056 %	43 102	11, 100 %	345 197
TOTALI	3 303 450	100, 000 %	369 738	11, 192 %	246 180	1 953 820	2 200 000	5 503 450	100, 000 %	615 918	11, 191 %	4 887 532

LIGJ
Nr. 8/2012

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH)
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË BYPASS-EVE TË RRUGËS SË FIERIT DHE VLORËS**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të *bypass*-eve të rrugës së Fierit dhe Vlorës.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.2.2012

**Shpallur me dekretin nr.7288, datë 21.2.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Drafti i tretë

(Numri i veprimit 42319)

MARRËVESHJE HUAJE
**PROJEKTI I BYPASS-it TË FIERIT DHE VLORËS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Marrëveshje e datës _____ (kjo Marrëveshje) ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka).

PREAMBUL

Duke marrë në konsideratë se Banka është krijuar për të ofruar financim për projekte specifike mbi zhvillimin e tranzicionit drejt ekonomive të orientuara nga tregu për promovimin e iniciativës private dhe sipërmarrëse në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, të angazhuara dhe që zbatojnë parimet e demokracisë shumëpalëshe, pluralizmit dhe ekonomive të tregut;

duke marrë në konsideratë se Huamarrësi synon të zbatojë projektin e përshkruar në skedulin 1 (projekti), i cili është projektuar për të ndihmuar Huamarrësin në: a) ndërtimin e një *bypass*-i 22 km në qytetin e Fierit (komponenti 1); dhe b) ndërtimin e një *bypass*-i 29 km në qytetin e Vlorës (komponenti 2);

duke marrë në konsideratë se Huamarrësi ka kërkuar ndihmë nga Banka për financimin e një pjese të projektit;

duke marrë në konsideratë se Huamarrësi synon të kontrakttojë një hua nga Banka Europiane e Investimeve (BEI) në shumën prej 35,000,000 eurosh (tridhjetë e pesë milionë euro) për të ndihmuar në financimin e pjesës B të komponentit 1 dhe një hua tjetër në shumën prej 18,000,000 eurosh



(tetëmbëdhjetë milionë euro) për të ndihmuar për financimin e pjesës B të komponentit 2, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuara në marrëveshjet përkatëse ndërmjet Huamarrësit dhe BEI-t (kontratat e financimit BEI);

duke marrë në konsideratë se Qeveria Italiane, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme për Bashkëpunim dhe Zhvillim (Kooperacioni Italian) ka rënë dakord të ofrojë një financim grandi prej 1,800,000 eurosh për Huamarrësin, pjesë e të cilit do të përdoret për financimin e pjesëve A dhe C të komponentit 1, sipas kushteve të një ose më shumë marrëveshjesh grandi ndërmjet Kooperacionit Italian dhe Huamarrësit (marrëveshjet e grandit të Kooperacionit Italian);

duke marrë në konsideratë se Komisioni European ka rënë dakord të ofrojë financim grandi për financimin e pjesëve A dhe C të komponentit 2, ndërsa këto grande arrijnë një shumë të përgjithshme prej 3,400,000 eurosh (tre milionë e katërqind mijë euro), dhe një financim grandi në shumën 18,000,000 euro për financimin e pjesës B të komponentit 2, në bazë të kushteve të një ose më shumë marrëveshjesh grandi ndërmjet Komisionit European dhe Huamarrësit (marrëveshjet e grandit të KE-së);

duke marrë në konsideratë se Banka ka rënë dakord mbi bazën e, ndër të tjera, sa më sipër, për t'i dhënë një hua Huamarrësit në shumën prej 53,000,000 eurosh (pesëdhjetë e tre milionë euro), të ndarë në një transh të zotuar prej 35,000,000 eurosh (tridhjetë e pesë milionë euro) për financimin e komponentit 1 dhe një transh të pazotuar 2 prej 18,000,000 eurosh (tetëmbëdhjetë milionë euro) për financimin e komponentit 2, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje,

rrjedhimisht, me anë të kësaj marrëveshjeje palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Termet dhe kushtet standarde; përkufizimet

Seksioni 1.01. Përfshirja e termave dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e termave dhe kushteve standarde të Bankës, të datës 1 tetor 2007 janë përfshirë dhe bërë të zbatueshme për këtë Marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin përcaktuar plotësisht në të (këto dispozita më poshtë quhen “termat dhe kushtet standarde”).

Seksioni 1.02. Përkufizimet

Kurdoherë që përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë preambulën dhe skedulet), nëse nuk deklarohet ndryshe ose nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat e përkufizuar në preambulë kanë kuptimet përkatëse që u jepen në këtë Marrëveshje, termat e përkufizuar në termat dhe kushtet standarde kanë kuptimet përkatëse që u jepen atyre në këtë Marrëveshje dhe termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

“ASHRR” nënkupton Autoritetin Shqiptar të Rrugëve, të krijuar pas shndërrimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në një ndërmarrje publike.

“Përfaqësues i autorizuar i Huamarrësit” nënkupton Ministrin e Financave të Huamarrësit.

“Komponent 1” ka kuptimin që i jepet në preambulën e kësaj Marrëveshjeje.

“Komponent 2” ka kuptimin që i jepet në preambulën e kësaj Marrëveshjeje.

“Kërkesat e përcaktuara të performancës” nënkuptojnë kërkesat e performancës 1 deri 8 dhe 10 (ose siç mund të kërkojë konteksti, secilën nga këto kërkesa performance) të kërkesave të performancës të muajit maj 2008 dhe në lidhje me politikën mjedisore dhe sociale të Bankës të muajit maj 2008.

“Marrëveshjet e grandit të KE-së” ka kuptimin që i jepet në preambulën e kësaj Marrëveshjeje.

“BEI” ka kuptimin që i jepet në preambulën e kësaj Marrëveshjeje.

“Kontratat e financimit të BEI-t” ka kuptimin që i jepet në preambulën e kësaj Marrëveshjeje.

“Plan i veprimit social dhe mjedisor për komponentin 1” nënkupton planin e veprimit social dhe mjedisor për komponentin 1 të datës [], të përgatitur nga Huamarrësi dhe të rënë dakord me Bankën, një kopje e të cilit i bashkëlidhet kësaj Marrëveshjeje, si skeduli 3, siç ky plan mund të ndryshohet herë pas here me pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës.

“Plan i veprimit social dhe mjedisor për komponentin 2” nënkupton planin social dhe mjedisor të veprimit për komponentin 2, i cili do të bihet dakord me Bankën përpara datës së fillimit të transhit B.

“Planet mjedisore dhe sociale të veprimit” nënkupton planin mjedisor dhe social të veprimit për komponentin 1 dhe planin mjedisor dhe social të veprimit për komponentin 2.

“Ligj mjedisor dhe social” nënkupton çdo ligj ose rregullore të zbatueshme, që lidhet me:

a) ndotjen ose mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë ligjet dhe rregulloret që lidhen me aksesin publik në informacion dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje;

b) kushtet e punës dhe punësimit;

c) sigurinë dhe shëndetin profesional;

d) shëndetin publik dhe sigurinë;

e) popujt indigjenë;

f) trashëgiminë kulturore; ose

g) rivendosjen ose zhvendosjen ekonomike të personave.

“Çështje mjedisore dhe sociale” nënkupton çdo çështje që i nënshtrohet ligjit mjedisor dhe social, çdo kërkesë të përcaktuar të performancës ose plane mjedisore dhe sociale të veprimit.

“Vit fiskal” nënkupton vitin fiskal të Huamarrësit që fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

“Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve” nënkupton Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, një departament pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, ose pasi të shndërrohet në ASHRR, do të nënkuptojë ASHRR (ose, sipas rastit, pasardhësin e tij herë pas here).

“Kooperacioni Italian” ka kuptimin që i jepet në preambulën e kësaj Marrëveshjeje.

“Marrëveshje të grandit të Kooperacionit Italian” ka kuptimin që i jepet në preambulën e kësaj Marrëveshjeje.

“Të drejtat e truallit” nënkupton të drejtat e përdorimit të truallit, të nevojshme për zbatimin e pjesës B të komponentit 1 dhe komponentit 2.

“Sistem i menaxhimit të informacionit” nënkupton sistemet e menaxhimit të informacionit dhe proceset që do t’i japin mundësinë ARRSH-së të përmbushë me efektivitet rolin e saj të caktuar.

“Ministria e Punëve Publike dhe Transportit” nënkupton Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit të Republikës së Shqipërisë.

“EZP” nënkupton ekipin e zbatimit të projektit të përmendur në seksionin 3.03.

“Kontratë mirëmbajtjeje e bazuar në performancë” nënkupton një kontratë për mirëmbajtjen e rrugëve, ku pagesa e kontraktorit përfshin parametrat e performancës.

“Projekt” ka kuptimin që i jepet në preambulën e kësaj Marrëveshjeje.

“Plan i veprimit për rivendosjen për komponentin 1” nënkupton planin e veprimit të rivendosjes për komponentin 1, të përfunduar nga ARRSH dhe të dorëzuar Bankës nga ARRSH-ja në emër të Huamarrësit, plani i të cilit do të zbatohet në përputhje me kërkesat e politikës sociale dhe mjedisore të Bankës.

“Plan i veprimit për rivendosje për komponentin 2” nënkupton planin e veprimit për rivendosje për komponentin 2, i cili do të bihet dakord me Bankën përpara datës së fillimit të transhit B.

“Planet e veprimit për rivendosje” nënkupton planin e veprimit për rivendosje për komponentin 1 dhe planin e veprimit për rivendosje për komponentin 2.

“Strategjia e taksave rrugore” nënkupton strategjinë e taksave rrugore për Shqipërinë, të përgatitur nga konsulentët për Huamarrësin. Strategjia e taksave rrugore do të formulojë politikën e taksave rrugore dhe do të identifikojë seksionet që mund të jenë të përshtatshme për taksim rrugor në Shqipëri.

“Studim i qëndrueshëm i transportit” nënkupton studimin e qëndrueshëm të transportit të përgatitur nga konsulentët për Huamarrësin. Politika e qëndrueshme e transportit do të identifikojë masat për përmirësimin e qëndrueshmërisë së sektorit të transportit në Shqipëri.

“Hua e transhit A” nënkupton huan e parashikuar në Marrëveshjen e huas sipas transhit A.

“Hua e transhit B” nënkupton huan e parashikuar në Marrëveshjen e huas sipas transhit B.

“Datë e fillimit të transhit B” nënkupton datën në të cilën janë përmbushur të gjitha kushtet e përcaktuara në seksionin 6.04 të kësaj Marrëveshjeje, të pranueshme për Bankën dhe Banka ka



konfirmuar se është e gatshme t'i vërë në dispozicion Huamarrësit huan e transhit B, sipas termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.03. Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, një referencë ndaj një neni, seksioni ose skeduli të specifikuar, përveç kur deklarohet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si referencë ndaj atij neni ose seksioni, ose skeduli të specifikuar të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Kushtet kryesore të huas

Seksioni 2.01. Shuma dhe monedha

a) Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuara ose që përmenden në këtë Marrëveshje, shumën prej 53,000,000 eurosh (pesëdhjetë e tre milionë euro).

b) Huaja përbëhet nga dy transhet e mëposhtme:

1. Transhi A në shumën prej 35,000,000 eurosh (tridhjetë e pesë milionë euro); dhe

2. Transhi B në shumën prej 18,000,000 eurosh (tetëmbëdhjetë milionë euro).

Seksioni 2.02. Kushtet e tjera financiare të huas

a) Shuma minimale e tërheqjes është 300,000 euro (treqind mijë euro).

b) Shuma minimale e parapagimit është 3,000,000 euro (tre milionë euro).

c) Shuma minimale e anulimit është 1,000,000 euro (një milion euro).

d) Datat e pagimit të interesit janë 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti.

e) 1. Huamarrësi shlyen huan e transhit A në 24 (njëzet e katër) këste të barabarta (ose pothuajse sa më të barabarta që të jetë e mundur) gjashtëmujore në datat 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti, me datën e parë të shlyerjes së huas për transhin A që bie në datën e ardhshme të pagimit të interesit pas përvjetorit të tretë të kësaj Marrëveshjeje.

2. Huamarrësi shlyen huan e transhit B në 24 (njëzet e katër) këste të barabarta (ose pothuajse sa më të barabarta që të jetë e mundur) gjashtëmujore në datat 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti, me datën e parë të shlyerjes së huas për transhin B që bie në datën e ardhshme të pagimit të interesit pas përvjetorit të tretë të datës së fillimit të transhit B.

3. Pavarësisht nga sa më sipër, në rast se: i) Huamarrësi nuk tërheq të gjithë transhin A dhe/ose, sipas rastit, shumën e transhit B përpara datës së shlyerjes së parë të huas të përcaktuar në seksionin 2.02.(e); dhe ii) Banka shtyn datën e fundit të disponueshmërisë, të përcaktuar në seksionin 2.02.(f) në lidhje me transhin A dhe/ose, sipas rastit, transhin B më poshtë në një datë që bie pas kësaj date të shlyerjes së parë të huas, atëherë shumën e secilës tërheqje të bërë në ose pas datës së shlyerjes së parë të huas do të alokohet për shlyerje në shumën të barabartë në disa data të shlyerjes së huas që bien pas datës së kësaj tërheqjeje (ndërsa Banka rregullon shumën e alokuara, të cilat janë të nevojshme për të arritur në çdo rast numrat e plotë). Banka, herë pas here, njofton Huamarrësin në lidhje me këto alokime.

f) Data e fundit e disponueshmërisë për huan e transhit A është 30 prill 2015 dhe për huan e transhit B është data e përvjetorit të tretë të datës së fillimit të transhit B, ose një datë e mëvonshme që Banka, sipas diskrecionit të saj, mund të vendosë dhe njofton Huamarrësin. Nëse shumën e disponueshme e huas ose ndonjë pjesë e saj i nënshtrohet një norme fikse interesi dhe Banka shtyn datën e fundit të disponueshmërisë, Huamarrësi do t'i paguajë menjëherë Bankës këtë shumë të kostove të pashlyera, siç do të njoftohet nga Banka me shkrim për Huamarrësin.

g) Norma e tarifës së detyrimit financiar është 0.5% në vit. Tarifa e detyrimit financiar për huan e transhit B është e pagueshme nga data e fillimit të transhit B.

h) Huaja i nënshtrohet një norme të ndryshueshme interesi. Pavarësisht nga sa më sipër, si alternativë ndaj interesit të pagueshëm në një normë të ndryshueshme interesi mbi të gjithë ose ndonjë pjesë të huas në atë kohë të papaguar, Huamarrësi mund të zgjedhë të paguajë interes në një normë fikse interesi për këtë pjesë të huas, në përputhje me seksionin 3.04(c) të termave dhe kushteve standarde.

Seksioni 2.03. Tërheqjet

Shuma e disponueshme mund të tërhiqet herë pas here në përputhje me dispozitat e skedulit 2 për të financuar: 1) shpenzimet e kryera (ose nëse Banka bie dakord që të kryhen) në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave, punimeve dhe shërbimeve të kërkuara për projektin; dhe 2) komisionin fillestar.

Seksioni 2.04. Përfaqësuesi i autorizuar për tërheqjet

Ministri i Financave i Huamarrësit caktohet si përfaqësues i autorizuar i Huamarrësit për qëllimin e marrjes së çdo mase të kërkuar ose të lejuar për t'u marrë sipas dispozitave të seksionit 2.03 të kësaj Marrëveshjeje dhe sipas dispozitave të seksioneve 3.01 dhe 3.02 të termave dhe kushteve standarde, përveç kur Ministri i Financave, herë pas here, mund të caktojë një partner për të vepruar si përfaqësues i autorizuar i Huamarrësit në lidhje me këtë veprim.

Neni 3

Ekzekutimi i projektit

Seksioni 3.01. Marrëveshje të tjera zotuese të projektit

Përveç sipërmarrjeve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 4 të termave dhe kushteve standarde, Huamarrësi, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe:

a) merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar fonde të mjaftueshme për përfundimin e projektit dhe i vë të gjitha këto fonde në dispozicion të projektit si kontribute të parimbursueshme për financimin e kostove të projektit; dhe

b) përmbush të gjitha detyrimet e saj sipas ose në lidhje me kontratat e financimit të BEI-t, Marrëveshjeve të grandit të Kooperacionit Italian, marrëveshjeve të grandit të KE-së dhe të gjitha marrëveshjeve të tjera që lidhen me projektin.

Seksioni 3.02. Forcimi institucional

a) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, përgatit strategjinë e taksave rrugore dhe i dorëzon Bankës një dokument me shkrim që përcakton këtë strategji deri në datën 30 qershor 2013.

b) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, lidh dy kontrata mirëmbajtjeje të bazuara në performancë për mirëmbajtjen e rrugëve në dy rajone (qarqe) deri në datën 31 dhjetor 2012 (pa përfshirë qarqet e Tiranës dhe Kukësit që tashmë kanë zbatuar kontratat e mirëmbajtjes të bazuara në performancë).

c) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, lidh një marrëveshje koncesioni për mirëmbajtjen dhe funksionimin e rrugës Milot-Morinë, të pranueshme për Bankën, deri në 31 dhjetor 2013.

d) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, i jep studimin e qëndrueshëm të transportit Bankës deri në datën 31 mars 2013.

e) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, zbaton sistemin e menaxhimit të informacionit pranë ASHRR-së deri në datën 30 prill 2012.

Seksioni 3.03. Ekipi i zbatimit të projektit

Me qëllim bashkërendimin, menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e të gjitha aspekteve të zbatimit të projektit, duke përfshirë prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve për projektin, Huamarrësi, nëse nuk bihet dakord ndryshe me Bankën, garanton se në çdo kohë gjatë ekzekutimit të projektit, është në funksionim një ekip/njësi i/e zbatimit të projektit me burime të mjaftueshme dhe personel të kualifikuar në nivel të përshtatshëm, sipas termave të referencës të pranueshme për Bankën.

Seksioni 3.04. Prokurimi

Për qëllime të seksionit 4.03 të termave dhe kushteve standarde, dispozitat e mëposhtme, përveç kur Banka bie dakord ndryshe, rregullojnë prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e huas:

a) Mallrat, punimet dhe shërbimet (të ndryshme nga shërbimet e konsulentëve që përfshihen brenda seksionit 3.04 "c") prokurohen nëpërmjet një procesi të hapur tenderimi.



b) Për qëllime të seksionit 3.04 “a”, procedurat për tenderim të hapur përcaktohen në kapitullin 3 të rregullave të prokurimit të BERZH-it.

c) Konsulentët që do të punësohen nga Huamarrësi në lidhje me projektin, përzgjidhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në kapitullin 5 të rregullave të prokurimit të BERZH-it.

d) Të gjitha kontratat e punimeve u nënshtrohen procedurave të rishikimit të përcaktuara në rregullat e prokurimit të BERZH-it dhe i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës.

Seksioni 3.05. Marrëveshjet e pajtueshmërisë mjedisore dhe sociale

Pa kufizuar përgjithësimin e seksioneve 4.02 “a”, 4.04 (a)(iii), dhe 5.02(c)(iii) të termave dhe kushteve standarde, Huamarrësi, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe:

a) Përveç kur përcaktohet ndryshe në planet mjedisore dhe sociale të veprimit, Huamarrësi do të realizojë dhe do të marrë masa që çdo kontraktor të përmbushë projektin në përputhje me kërkesat e përcaktuara të performancës;

b) Jo më vonë se 180 ditë përpara datës së parashikuar të fillimit të transhit B, Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, i paraqet Bankës për aprovim një plan të propozuar të lehtësimit mjedisor dhe social dhe të masave të përmirësimit, duke përcaktuar kriteret e përmbushjes mjedisore dhe sociale, standardet, politikat, procedurat, praktikatat, investimet e kapitalit dhe skedulet e zbatimit, duke përfshirë masat për arritjen dhe ruajtjen e përputhshmërisë me kërkesat e përcaktuara të performancës. Pas aprovimit të këtij plani nga Banka, ky plan do të përbëjë planin mjedisor dhe social të veprimit për komponentin 2, për qëllime të kësaj Marrëveshjeje.

c) Pa u kufizuar në sa më sipër, Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, zbaton dhe i përmbahet me kujdes planeve mjedisore dhe sociale të veprimit dhe planeve të veprimit të rivendosjes, dhe monitoron zbatimin e këtyre planeve në përputhje me dispozitat monitoruese në përmbajtje të këtyre planeve.

d) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, dhe Banka mund të bien dakord herë pas here të ndryshojnë planet mjedisore dhe sociale të veprimit, në përgjigje të ndryshimeve në rrethanat e projektit ose Huamarrësit, rasteve të paparashikuara dhe rezultateve të monitorimit. Pa kufizuar përgjithësimin e sa më sipër:

1. nëse ka ndikime negative mjedisore ose sociale ose çështje që nuk ishin parashikuar ose përfshirë në planet mjedisore dhe sociale të veprimit, qoftë tërësisht ose për pjesë të saj;

2. nëse ndonjë masë lehtësuese ndikimi, e përcaktuar në planet mjedisore dhe sociale të veprimit nuk është e mjaftueshme për të eliminuar ose zvogëluar ndikimet mjedisore ose sociale në nivelin e parashikuar nga kërkesat përkatëse të përcaktuara të performancës brenda afatit kohor të përcaktuar në planet mjedisore dhe sociale të veprimit; ose

3. nëse ndonjë mospërputhshmëri materiale me planet mjedisore dhe sociale të veprimit ose me ligjin mjedisor dhe social është identifikuar nga një inspektim nga ndonjë autoritet rregullator ose përmbartimor ose nga një audit i kryer në përputhje me seksionin 3.04(d),

Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në bazë të pëlqimit të Bankës, do të përgatisë dhe përfshijë në planet mjedisore dhe sociale të veprimit ato masa shtesë ose të rishikuara lehtësuese që mund të jenë të nevojshme për arritjen e pajtueshmërisë me kërkesat e përcaktuara të performancës, në çdo rast në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

Seksioni 3.06. Konsulentët

a) Me qëllim që të ndihmojë për zbatimin e Projektit, Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, nëse nuk bihet dakord ndryshe me Bankën, punëson ose merr masa për punësimin, siç kërkohet, dhe shfrytëzon konsulentët me kualifikime, përvojë dhe terma reference të pranueshme për Bankën, duke përfshirë:

1. konsulentët për të ndihmuar për zbatimin e projektit të përmendur në pjesën C të komponentit 1 dhe Komponentit 2; dhe

2. konsulentët për të ndihmuar EZP-në.

b) Huamarrësi i jep pa pagesë konsulentëve të angazhuar për të ndihmuar për çështjet që lidhen me projektin ose operacionet e Huamarrësit, të gjitha lehtësirat dhe mbështetjen e nevojshme për përmbushjen e funksionit të tij, si dhe të gjitha dokumentet, materialet dhe informacione të tjera që mund të lidhen me punën e tyre.

Seksioni 3.07. Shpeshësia e raportimeve dhe kërkesat e paraqitjes

a) Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi dhe derisa shuma e plotë e huas të jetë shlyer ose anuluar, Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, i paraqet Bankës raportet vjetore mbi çështjet mjedisore dhe sociale që lindin në lidhje me Huamarrësin ose projektin brenda 90 ditësh pas përfundimit të vitit kur raportohen. Këto raporte përfshijnë informacione mbi çështjet e mëposhtme specifike:

1. Informacion mbi respektimin nga Huamarrësi të kërkesave të përcaktuara të performancës, të përshkruara në seksionin 3.05(a) dhe zbatimin e planeve mjedisore dhe sociale të veprimit;

2. Informacion mbi mënyrën si Huamarrësi ka monitoruar respektimin e kërkesave të përcaktuara të performancës dhe planeve mjedisore dhe sociale të veprimit nga çdo kontraktor i angazhuar për projektin dhe një përmbledhje të çdo mospërputhshmërie materiale nga ky kontraktor me kërkesat e përcaktuara të performancës dhe planet mjedisore dhe sociale të veprimit dhe të çdo mase të marrë për korrigjimin e kësaj mospajtueshmërie;

3. Informacion në lidhje me zbatimin e planit të angazhimit të aktorit në bazë të kërkesës së përcaktuar të performancës 10, duke përfshirë një përmbledhje të çdo ankese të marrë dhe mënyrën si këto ankese janë zgjidhur;

4. Informacion mbi respektimin nga Huamarrësi të ligjeve mjedisore dhe sociale në lidhje me projektin, duke përfshirë statusin e çdo autorizimi të kërkuar për projektin, rezultatet e çdo inspektimi të kryer nga ndonjë autoritet rregullator, çdo shkelje të ligjeve, rregulloreve ose standardeve të zbatueshme, dhe çdo masë korrigjuese ose gjorbë në lidhje me këtë shkelje dhe një përmbledhje të çdo njoftimi material, raporti dhe komunikimi tjetër mbi çështjet mjedisore dhe sociale që lidhen me projektin, të paraqitura nga Huamarrësi çdo autoriteti rregullator;

5. Informacion mbi shëndetin profesional dhe menaxhimin e sigurisë dhe të dhëna mbi shëndetin profesional dhe sigurinë e projektit, duke përfshirë nivelet e aksidenteve, aksidentet e personelit që shkaktojnë paaftësi në punë dhe aksidentet potenciale, çdo masë lehtësuese ose parandaluese të marrë ose të planifikuar nga Huamarrësi, çdo trajnim personeli mbi shëndetin profesional dhe sigurinë dhe çdo iniciativë tjetër në lidhje me shëndetin profesional dhe menaxhimin e sigurisë që është zbatuar ose planifikuar nga Huamarrësi;

6. Një përmbledhje të çdo ndryshimi në ligjet mjedisore dhe sociale që mund të ketë ndikim material te projekti; dhe

7. Kopje të çdo informacioni mbi çështjet mjedisore dhe sociale të paraqitura rregullisht nga Huamarrësi për publikun e përgjithshëm.

b) Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, i paraqet raporte periodike tremujore të projektit të përmendura në seksionin 4.04 “a” “iv” të termave dhe kushteve standarde, brenda 45 ditësh pas përfundimit të periudhës së raportimit deri në përfundimin e projektit. Këto raporte përfshijnë elementet e mëposhtme specifike:

1. Informacioni i mëposhtëm i përgjithshëm:

A) progresi fizik i kryer në zbatimin e projektit deri në datën e raportit dhe gjatë periudhës së raportimit;

B) vështirësitë ose vonesat aktuale, ose të pritshme për zbatimin e projektit dhe ndikimi i tyre në skedulën e zbatimit, dhe hapat aktualë ose të planifikuar të marrë për kapërcimin e vështirësive dhe shmangien e vonesave;

C) ndryshimet e pritshme në datën e përfundimit të projektit;

D) ndryshime kryesore të personelit në burimet njerëzore të EZP-së, konsulentët ose kontraktorin (ët) e punimeve civile;

E) çështjet që mund të ndikojnë në koston e projektit; dhe



F) çdo zhvillim ose aktivitet, i cili mund të ndikojë në realizueshmërinë ekonomike të ndonjë pjese të projektit.

2. Një diagram i progresit në formë grafiku, bazuar në skedulën e zbatimit të projektit, e cila tregon progresin në çdo pjesë të projektit dhe përfshin një grafik të shpenzimeve aktuale dhe të planifikuara.

3. Pasqyra financiare që tregojnë informacione të hollësishme të shpenzimeve të shkaktuara sipas çdo pjese të projektit dhe tërheqjeve, së bashku me një deklaratë që tregon:

A) preventivat fillestarë të shpenzimeve;

B) preventivat e rishikuar të shpenzimeve, nëse ka, me arsyet për ndryshime;

C) shpenzimet fillestare të llogaritura dhe shpenzimet aktuale deri tani;

D) arsyet për ndryshimet e shpenzimeve aktuale deri tani nga shpenzimet e llogaritura fillestare deri tani; dhe

E) shpenzimet e llogaritura për semestrat e mbetur të vitit.

4. Një deklaratë të shkurtër të statusit të pajtueshmërisë me secilën prej marrëveshjeve në përmbajtje të kësaj Marrëveshjeje.

c) Menjëherë pas ndodhjes së çdo incidenti ose aksidenti në lidhje me Huamarrësin, ose projektin, që ka ose mund të ketë ndikim të konsiderueshëm negativ në mjedis ose në shëndetin publik ose profesional, ose sigurinë, Huamarrësi do të informojë Bankën dhe menjëherë më pas, do të njoftojë Bankën për këtë, duke përcaktuar natyrën e këtij incidenti ose aksidenti dhe të çdo hapi që Huamarrësi merr për përmirësimin e kësaj situate. Pa kufizuar përgjithësimin e sa më sipër:

1. Një incident ose aksident që lidhet me projektin, nëse ndodh në ndonjë vend të përdorur për projektin ose nëse shkaktohet nga shërbimet, pajisjet, automjetet ose anijet e përdorura për ose në lidhje me projektin (pavarësisht nëse përdoren apo jo në ndonjë vend të projektit dhe nëse përdoren apo jo nga persona të autorizuar apo të paautorizuar);

2. Një incident ose aksident çmohet të ketë ndikim të konsiderueshëm negativ në mjedis ose në shëndetin publik ose profesional, ose sigurinë, nëse:

A) çdo ligj i zbatueshëm kërkon njoftimin e këtij incidenti ose aksidenti për çdo autoritet Qeveritar;

B) një incident ose aksident i tillë përfshin aksidentin e një personi (pavarësisht nëse ky person është punësuar apo jo nga Huamarrësi);

C) më shumë se një person (pavarësisht nëse këta persona janë punësuar apo jo nga Huamarrësi) ka marrë plagë të rënda që kërkojnë shtrim në spital; ose

D) ky incident ose aksident është bërë ose mund të bëhet njoftim publik, qoftë nëpërmjet publikimit në media, apo ndryshe.

d) Huamarrësi njofton menjëherë Bankën për çdo kundërshtim të fuqishëm nga punëtorët ose anëtarët e publikut të drejtuar për ose në lidhje me Huamarrësin ose projektin, që mund të kishte ndikim negativ material te Huamarrësi ose projekti, ose që është bërë ose mund të bëhet njoftim publik nëpërmjet publikimit në media apo ndryshe.

Brenda dhjetë ditësh pas këtij njoftimi, Huamarrësi do të paraqesë një raport të pranueshëm për Bankën, i cili përcakton rezultatin e hetimit të Huamarrësit për këtë kundërshtim dhe çdo hap të marrë ose që propozohet të merret nga Huamarrësi për zgjidhjen e çështjeve të ngritura në kundërshtim.

Neni 4

Marrëveshjet financiare

Seksioni 4.01. Të dhënat dhe raportet financiare

a) Në lidhje me departamentet ose agjencitë e Huamarrësit, përgjegjëse për kryerjen e projektit ose ndonjë pjese të tij, Huamarrësi shfrytëzon procedura, të dhëna dhe llogari të mjaftueshme për të reflektuar në përputhje me standardet e kontabilitetit të pranuar ndërkombëtarisht, operacionet, burimet dhe shpenzimet që lidhen me projektin dhe për të monitoruar dhe regjistruar progresin e projektit (duke përfshirë kostot e tij dhe përfitimet që rrjedhin nga projekti).

b) Huamarrësi:

1. ia nënshtron të dhënat dhe llogaritë e përmendura në seksionin 4.01(a) për çdo vit fiskal, auditimit nga auditë të pavarur të pranueshëm për Bankën, në përputhje me parimet dhe standardet e auditimit të pranueshëm ndërkombëtarisht;

2. i jep Bankës sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast, jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të çdo viti fiskal, raportin e këtij auditit nga këta auditë dhe fushën e veprimit dhe në hollësi që Banka mund të kërkojë; dhe

3. i jep Bankës çdo informacion tjetër në lidhje me këto të dhëna dhe llogari, dhe auditin e tyre, që Banka mund të kërkojë herë pas here.

Neni 5

Pezullimi, përshpejtimi

Seksioni 5.01. Pezullimi

Sa më poshtë, përcaktohen për qëllime të seksionit 7.01 “a” “xvii” të termave dhe kushteve standarde:

a) kuadri legjislativ dhe rregullator i zbatueshëm për sektorin e rrugëve në territorin e Huamarrësit do të jetë ndryshuar, pezulluar, miratuar, shfuqizuar ose hequr dorë në një mënyrë të ndryshme nga aprovimi nga Banka me shkrim; ose

b) e drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje sipas kontratave të financimit të BEI-t, marrëveshjeve të grandit të Kooperacionit Italian ose marrëveshjeve të grandit të KE-së, do të jenë pezulluar, anuluar ose përfunduar tërësisht ose pjesërisht, në bazë të kushteve të marrëveshjeve përkatëse, megjithatë, me kusht që dispozitat e këtij paragrafi të mos zbatohen nëse Huamarrësi përcakton, në masën e pranueshme për Bankën, se grandet ose huat koncesionare të mjaftueshme për sigurimin e fondeve të përshtatshme për projektin, janë në dispozicion të Huamarrësit nga burime të tjera në bazë të termave dhe kushteve të pajtueshme me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 5.02. Përshpejtimi i maturitetit

Sa më poshtë, përcaktohen për qëllimet e seksionit 7.06 “f” të termave dhe kushteve standarde:

Çdo rast i përcaktuar në seksionin 5.01 që do të ketë vazhduar për tridhjetë ditë pasi Banka të ketë njoftuar Huamarrësin në lidhje me vendimin e Bankës se ky rast ka ndodhur, duke përmendur në të gatishmërinë e Bankës për të marrë masa në përputhje me seksionin 7.06 të termave dhe kushteve standarde.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Seksioni 6.01. Kushtet pararendëse për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe disponueshmëria e transhit A

Sa më poshtë, përcaktohen për qëllimet e seksionit 9.02 “c” të termave dhe kushteve standarde si kushte shtesë për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje:

a) Bankës i janë paraqitur të dhëna dokumentuese, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, të miratimit nga parlamenti të kësaj Marrëveshjeje.

b) Bankës i janë paraqitur të dhëna dokumentuese, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, të zbatimit të duhur të planit mjedisor dhe social të veprimit për komponentin 1;

c) Bankës i janë paraqitur të dhëna dokumentuese, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, se të gjitha të drejtat e truallit, të nevojshme për zbatimin e komponentit 1, janë marrë nga Huamarrësi dhe janë vënë në dispozicion të kontraktorit të punimeve civile (ose se Huamarrësi ka të drejtë të fitojë këto të drejta trualli në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm shqiptar dhe se shumata e mjaftueshme janë rezervuar nga Huamarrësi për fitimin e këtyre të drejtave të truallit në kohën e duhur) dhe konfirmim se plani i veprimit të rivendosjes për komponentin 1 është duke u zbatuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara të performancës.



d) Bankës i janë paraqitur të dhëna dokumentuese, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, se një EZP është funksional, me burimet e mjaftueshme dhe personel të kualifikuar siç duhet, në bazë të termave të referencës të pranueshme për Bankën.

e) Dhe Bankës i janë paraqitur të dhëna dokumentuese, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, se marrëveshjet e grantit të Kooperacionit Italian për pjesën C të komponentit 1 janë ekzekutuar dhe dorëzuar dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë, dhe se e drejta e Huamarrësit për të tërhequr sipas kësaj marrëveshjeje, është bërë e vlefshme.

Seksioni 6.02. Opinioni ligjor

Për qëllimet e seksionit 9.03 “a” të termave dhe kushteve standarde, opinioni ose opinionet e përfaqësuesit ligjor do të jepen në emër të Huamarrësit nga Ministri i Drejtësisë dhe do të jenë në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

Seksioni 6.03. Përfundimi për moshyrjen në fuqi

Data që bie 120 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje është përcaktuar për qëllimet e seksionit 9.04 të termave dhe kushteve standarde.

Seksioni 6.04. Kushtet për disponueshmërinë e transhit B

Transhi B do të vihet në dispozicion, me diskrecionin e plotë të Bankës, në bazë të respektimit të kushteve të mëposhtme:

a) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, i ka dorëzuar Bankës dokumentacionin e projektit për komponentin 2, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën;

b) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, i ka dorëzuar Bankës një dokument që përcakton strategjinë e taksave rrugore, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën;

c) Huamarrësi i ka paraqitur Bankës një plan financimi dhe prova të disponueshmërisë së këtij financimi për komponentin 2, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën;

d) Huamarrësi përmbush të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

e) Bankës i janë paraqitur të dhëna dokumentuese, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, se projekti është strukturuar për të respektuar kërkesat e përcaktuara të performancës dhe se studimet mjedisore dhe sociale për kontrollin e biznesit, njoftimi i informacioneve dhe angazhimi i aktorit për komponentin 2, janë realizuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara të performancës;

f) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, i ka dorëzuar Bankës një plan mjedisor dhe social veprimi për komponentin 2, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën;

g) Bankës i janë paraqitur të dhëna dokumentuese, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, se Huamarrësi ka realizuar komponentin 1 në pajtim me kërkesat e përcaktuara të performancës, planin mjedisor dhe social të veprimit për komponentin 1 dhe planin e veprimit të rivendosjes për komponentin 1;

h) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, i ka paraqitur Bankës një plan veprimi të rivendosjes për komponentin 2, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën; dhe

i) Bankës i janë paraqitur të dhëna dokumentuese, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, se të gjitha të drejtat e truallit të nevojshme për zbatimin e komponentit 2 janë fituar nga Huamarrësi dhe janë vënë në dispozicion të kontraktorit të punimeve civile (ose se Huamarrësi ka të drejtë të fitojë këto të drejta trualli në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm shqiptar dhe se shumica e mjaftueshme janë rezervuar nga Huamarrësi për fitimin e këtyre të drejtave të truallit në kohën e duhur) dhe konfirmim se plani i veprimit të rivendosjes është duke u zbatuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara të performancës.

Neni 7
Të ndryshme

Seksioni 7.01. Njoftimet

Adresat e mëposhtme përcaktohen për qëllime të seksionit 10.01 të termave dhe kushteve standarde:

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.1,
Tiranë Shqipëri
Në vëmendje të: Ministrit të Financave
Faks: (355) (4) 2228 494

Për Bankën:
Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom
Në vëmendje të: Njësisë së Administrimit të Operacioneve
Faks: +44-20-7338-6100

Në dëshmi të kësaj, palët e kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në katër kopje dhe e kanë dorëzuar në Tiranë, Shqipëri, në datën dhe vitin e shkruar fillimisht më sipër.

SKEDULI 1
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Qëllimi i projektit është të ndihmojë Huamarrësin në:
 - ndërtimin e një *bypass*-i 22 km në qytetin e Fierit;
 - ndërtimi i një *bypass*-i 29 km në qytetin e Vlorës.
2. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:
 - a) Komponenti 1
 - Pjesa A: Përgatitje e dizenjove inxhinierike dhe dokumenteve të tenderit
 - Pjesa A e komponentit 1 është financuar nga Kooperacioni Italian.
 - Pjesa B: Ndërtimi i *bypass*-i 22 km në qytetin e Fierit
 - Punimet për pjesën B të komponentit 1, duke përfshirë taksat, do të bashkëfinancohen me BEI-n. Huamarrësi financon blerjen e truallit dhe të gjitha taksat në lidhje me pjesën B të komponentit 1 (duke përfshirë në lidhje me kontratat e punimeve civile).
 - Pjesa C: Mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit për komponentin 1 të përmendur në pjesën B
 - Një konsulent mbikëqyrjeje është emëruar për të monitoruar zbatimin e punimeve sipas pjesës B të komponentit 1. Këto shërbime financohen nga Kooperacioni Italian.
 - b) Komponenti 2
 - Pjesa A: Përgatitja e dizenjove inxhinierike dhe dokumenteve të tenderit
 - Pjesa A e komponentit 2 financohet nga Komisioni European.
 - Pjesa B: Ndërtimi i një *bypass*-i 29 km në qytetin e Vlorës
 - Punimet për pjesën B të komponentit 2, duke përfshirë taksat, do të bashkëfinancohen me BEI-n dhe Komisionin European. Huamarrësi financon blerjen e truallit dhe të gjitha taksat në lidhje me pjesën B të komponentit 2 (duke përfshirë në lidhje me kontratat e punimeve civile).
 - Pjesa C: Mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit për komponentin 2 të përmendur në pjesën B.
 - Një konsulent mbikëqyrjeje emërohet për të monitoruar zbatimin e punimeve sipas pjesës B të komponentit 2. Këto shërbime do të financohen nga Komisioni European.
3. Komponenti 1 pritët të përfundojë deri në 30 qershor 2014 dhe komponenti 2 pritët të përfundojë deri në 30 qershor 2015.



SKEDULI 2 KATEGORITË DHE TËRHEQJET

1. Tabela bashkëlidhur këtij skeduli përcakton kategoritë, shumën e huas të alokuar për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen në çdo kategori.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 më lart, nuk do të bëhet asnjë tërheqje në lidhje me shpenzimet e bëra përpara datës së Marrëveshjes së huas.

SHTOJCA E SKEDULIT 2

Kategoria	Shuma e huas së alokuar në monedhën e huas	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen
1. Punimet për pjesën B të komponentit 1	34,650,000 euro	20.75 %, pa taksa*
2. Punimet për pjesën B të komponentit 2	17,820,00 euro	10.67% pa taksa*
3. Komisioni fillestar	530,000 euro	100 %
Totali	53,000,000 euro	

* Përqindja e financimit të përgjithshëm të projektit.

SKEDULI 3 PLANI MJEDISOR DHE SOCIAL I VEPRIMIT PËR KOMPONENTIN 1

LIGJ Nr. 9/2012

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT PËR ZHVILLIM ABU DHABI PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËS TIRANË-ELBASAN

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim Abu Dhabi për financimin e projektit të rrugës Tiranë-Elbasan.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.2.2012

**Shpallur me dekretin nr.7289, datë 21.2.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE HUAJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT PËR ZHVILLIM ABU DHABI PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËS TIRANË-ELBASAN

Marrëveshje e datës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (më poshtë i quajtur Huamarrësi) nga njëra anë, dhe Fondit për Zhvillim Abu Dhabi (më poshtë i quajtur Fondi) nga ana tjetër:

duke marrë në konsideratë se Huamarrësi ka kërkuar nga Fondi të marrë pjesë në financimin e projektit të rrugës Tiranë-Elbasan, që përshkruhet më specifikisht në skedulin e dytë të kësaj Marrëveshjeje (më poshtë i quajtur Projekti);

dhe duke marrë në konsideratë se Fondi synon të asistojë vendet arabe, afrikane, aziatike dhe vende të tjera me ekonomi në zhvillim, duke u dhënë atyre huat e nevojshme për realizimin e projekteve të tyre të zhvillimit;

dhe duke marrë në konsideratë se Fondi është i bindur për qëndrueshmërinë dhe realizueshmërinë e projektit dhe rëndësinë e tij për zhvillimin e ekonomisë së Huamarrësit;

dhe duke marrë në konsideratë se Fondi, në zbatim sa më lart, ka rënë dakord t'i japë Huamarrësit një hua në bazë të kushteve dhe afateve në përmbajtje të kësaj Marrëveshjeje, rrjedhimisht, është rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Huaja dhe kushtet e saj

1. Fondi bie dakord t'i japë Huamarrësit hua në bazë të kushteve dhe afateve të përcaktuara ose të përfshira me referencë në këtë Marrëveshje, një shumë të barasvlershme me njëqind e tetëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë (183,650,000) dirhamë të Emirateve.

2. Huamarrësi paguan interes në normën e katër e gjysmë për qind (4.5%) në vit, në bazë të shumës së principalit të huas së tërhequr dhe të papaguar. Interesi rritet nga datat përkatëse në të cilat do të tërhiqen shumat.

3. Huamarrësi paguan një tarifë të administrimit të huas në normën e zero pikë pesë për qind (0.5%) në vit mbi shumën e principalit të huas së tërhequr dhe të papaguar.

4. Tarifa e pagueshme për detyrime të veçanta financiare të kryera nga Fondi, me kërkesë të Huamarrësit sipas seksionit 2 të këtij neni 3, është në normën e zero pikë pesë për qind (0.5%) në vit mbi shumën e principalit të çdo detyrimi financiar të veçantë të papaguar herë pas here.

5. Interesi dhe tarifat e tjera llogariten mbi bazën e një viti 360 ditë me 12 muaj 30-ditorë për çdo periudhë më pak se gjashtë muaj.

6. Huamarrësi shlyen principalin e huas në përputhje me programin e amortizimit të përcaktuar në skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje, mbi bazën që periudha e shlyerjes të jetë 12 (dymbëdhjetë) vjet, e paraprirë nga tre (3) vjet si periudhë pa pagesë principal.

7. Interesi dhe tarifat e tjera janë të pagueshme çdo gjashtë muaj në datat 30 mars dhe 30 shtator të çdo viti.

8. Huamarrësi ka të drejtën, në bazë të pagesës së të gjithë interesit të shtuar dhe të gjitha tarifave të tjera, dhe pas dhënies së një njoftimi jo më pak se 45 ditë për Fondin, të shlyejë përpara maturimit:

- a) të gjithë shumën e principalit të huas që është e pashlyer deri në atë moment; ose
- b) të gjithë shumën e principalit të ndonjë ose më shumë maturiteteve, me kusht që në datën e parapagimit, nuk do të ketë pjesë të papaguar të huas që maturohet pas këtij parapagimi.

9. Principali dhe interesi, si dhe tarifat e tjera për huan paguhet në ato vende që do të kërkojë Fondi.



Neni 2

Dispozita mbi monedhën

1. Tërheqja e shumave të huas, shlyerja e saj, pagesa e interesit dhe tarifat e tjera, si dhe të gjitha llogaritë e transaksioneve financiare në lidhje me këtë Marrëveshje, do të jenë në dirhamë të Emirateve.

2. Me kërkesë të Huamarrësit dhe duke vepruar si agent i tij, Fondi blen çdo monedhë që nevojitet nga Huamarrësi për pagesën ose rimbursimin e kostos së mallrave të financuara nga huaja, në përputhje me këtë Marrëveshje. Shuma që konsiderohet e tërhequr nga huaja në këtë rast do të jetë e barabartë me shumën e dirhamëve të Emirateve, të kërkuara për blerjen e kësaj monedhe të huaj.

3. Me kërkesë të Huamarrësit dhe duke vepruar si agent i tij, Fondi blen atë shumë të dirhamëve të Emirateve që mund të kërkohet për shlyerjen, në përputhje me seksionin 1 të këtij neni, në çdo monedhë ose monedha të huaja të pranueshme për Fondin.

4. Kurdoherë që është e nevojshme për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, për të përcaktuar vlerën e një monedhe në lidhje me një tjetër, kjo vlerë do të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme nga Fondi.

Neni 3

Tërheqja dhe përdorimi i shumave të huas

1. Huamarrësi është i autorizuar të tërheqë nga huaja shumat e shpenzuara ose që do të shpenzohen për projektin, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Asnjë shumë nuk mund të tërhiqet nga huaja mbi bazën e shpenzimeve të shkaktuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nëse Fondi nuk bie dakord ndryshe.

2. Me kërkesë të Huamarrësit dhe në bazë të kushteve dhe afateve që do të bien dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit, Fondi mund të bëjë zotime të veçanta me shkrim për t'i paguar suma Huamarrësit ose të tjerëve në lidhje me koston e mallrave që do të financohen sipas kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga ndonjë pezullim ose anulim.

3. Kur Huamarrësi dëshiron të tërheqë një shumë nga huaja ose t'i kërkojë Fondit të bëjë një zotim të veçantë sipas seksionit pararendës, Huamarrësi i dërgon Fondit një kërkesë mbi format e parashikuara nga Fondi, të shoqëruar me dokumentet e nevojshme mbështetëse, megjithatë, në mënyrë që kur kryhet një tërheqje apo kur bëhet një zotim i veçantë përpara se kjo kërkesë ose këto dokumente mbështetëse t'i jenë paraqitur Fondit, ato të paraqiten menjëherë më pas.

4. Çdo kërkesë për tërheqje dhe dokumentet mbështetëse shoqëruese dhe prova të tjera duhet të jenë të mjaftueshme në formë dhe përmbajtje, në mënyrë që Fondi të bindet se Huamarrësi është i autorizuar të tërheqë nga huaja shumën e kërkuar dhe që shuma e cila do të tërhiqet nga huaja të përdoret vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

5. Huamarrësi përdor fondet e huas vetëm për financimin e kostove të arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për realizimin e projektit. Procedurat për prokurimin e këtyre mallrave dhe shërbimeve përcaktohen me marrëveshje ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit.

6. Huamarrësi merr masa që mallrat e financuara nga fondet e huas të përdoren vetëm për realizimin e projektit.

7. Pagesa nga Fondi e shumave që Huamarrësi është i autorizuar të tërheqë nga huaja, kryhet për ose me urdhër të Huamarrësit.

8. E drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga Huaja përfundon më 31.12.2015 ose në një datë tjetër që mund të bihet dakord herë pas here ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit.

Neni 4

Zotime të veçanta

1. Huamarrësi i vë në dispozicion fondet e huas Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit që do të ekzekutojë dhe operojë projektin (më poshtë i quajtur Përfituesi) sipas kësaj Marrëveshjeje huaje.

2. Huamarrësi dhe Ministria e lartpërmendur ngarkohen për ekzekutimin dhe administrimin e projektit, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe kërkesat e menaxhimit të shërbimeve publike dhe me parimet e qëndrueshme inxhinierike, financiare dhe teknike.

3. Me synim zbatimin efektiv të projektit, Huamarrësi merr masat e nevojshme për krijimin pranë Ministrisë, brenda gjashtë javëve nga data e Marrëveshjes, ose në një datë tjetër që mund të bihet dakord me Fondin, të një njësie të menaxhimit të projektit (NJMP), e cila do të jetë përgjegjëse për administrimin e ekzekutimit të projektit. NJMP-ja kryesohet nga një inxhinier i kualifikuar dhe me përvojë, i pranueshëm për Fondin, dhe përbëhet nga personel lokal i mjaftueshëm teknik, për çështjet e kontabilitetit dhe çështjet administrative, i pëlqyeshëm nga Fondi. Në interesin më të mirë të projektit, Huamarrësi merr masa që Ministria t'i japë NJMP-së burime të mjaftueshme, financim dhe shërbime dhe e autorizon atë me përgjegjësitë e nevojshme për të garantuar se bashkërendimi i duhur dhe kontaktet e nevojshme janë mbajtur për zbatimin e suksesshëm të punimeve të projektit.

4. Huamarrësi dhe/ose përfituesi caktojnë konsulentë inxhinierikë (ose konsulentë të tjerë që mund të kërkohen), të pranueshëm për mbikëqyrjen dhe realizimin e projektit.

5. Huamarrësi dhe/ose përfituesi i japin Fondit kopje të vërtetuara të të gjitha kontratave të lidhura përpara datës së kësaj Marrëveshjeje në lidhje me projektin.

6. Pas datës së kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi dhe/ose Përfituesi nuk do të ekzekutojnë kontrata të reja në lidhje me projektin, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Fondit.

7. Huamarrësi merr masat e nevojshme për fitimin e pronësisë së tokës ose të të drejtave mbi të, sipas kërkesave të ekzekutimit të projektit.

8. Huamarrësi dhe/ose përfituesi i dorëzojnë konsulentit inxhinierik dhe kontraktorit sheshin e projektit, të lirë nga të gjitha barrët dhe garanton të drejtën e përdorimit të tij.

9. Nëse ndodh që shumat e alokuara për financimin e projektit janë më të vogla sesa kostoja e llogaritur e ekzekutimit, Huamarrësi merr hapat që mund të jenë të nevojshëm për dhënien e shumave shtesë të kërkuara për realizimin e ekzekutimit. Në rast se shtohet një huadhënës i ri, ai duhet të jetë i pranueshëm për Fondin.

10. Huamarrësi dhe/ose Përfituesi i japin Fondit të gjitha studimet e fizibilitetit, planet dhe specifikimet e projektit, si dhe çdo ndryshim material të bërë ose që duhet të bëhet në to, në atë mënyrë që Fondi kërkon herë pas here.

11. Huamarrësi dhe/ose Përfituesi mundëson ose merr masa për ruajtjen e të dhënave të mjaftueshme për identifikimin e mallrave dhe shërbimeve të financuara nga të ardhurat e huas, dhe njofton përdorimin e tyre në projekt, për të treguar ecurinë e projektit (duke përfshirë koston e tij), dhe për të reflektuar, në përputhje me procedurat përkatëse që respektojnë praktikën e qëndrueshme dhe të mirëcaktuara të konstabilitetit, operacionet dhe gjendjen financiare të autoritetit që është duke realizuar projektin. Huamarrësi u ofron të gjitha mundësitë përfaqësuesve të akredituar të Fondit të kryejnë vizita për qëllime në lidhje me huan, dhe për të inspektuar ecurinë e punës, si dhe për të shqyrtuar të dhënat dhe dokumentet përkatëse, dhe i jep Fondit të gjithë informacionin që Fondi do të kërkojë në lidhje me shpenzimin e të ardhurave të huas, ekzekutimin e projektit dhe gjendjen financiare të Huamarrësit.

12. Huamarrësi dhe përfituesi marrin përsipër të drejtojnë dhe vazhdojnë Projektin në përputhje me standardet ndërkombëtare inxhinierike, financiare dhe teknike.

13. Huamarrësi dhe Fondi bashkëpunojnë plotësisht për të garantuar përmbushjen e qëllimeve të huas. Për këtë qëllim, çdo palë merr përsipër t'i japë tjetrës atë informacion dhe deklarata që mund të kërkojë në lidhje me gjendjen e përgjithshme të huas. Huamarrësi dhe Fondi shkëmbejnë herë pas here mendime nëpërmjet përfaqësuesve të tyre mbi çështje që lidhen me qëllimet e huas dhe vazhdimin e shërbimeve të saj. Huamarrësi informon menjëherë Fondin për çdo gjendje që ndërhyt ose rrezikon të ndërhyjë në realizimin e qëllimit të huas (duke përfshirë çdo rritje të dukshme në koston e projektit).

14. Synimi reciprok i Huamarrësit dhe Fondit është që asnjë borxh tjetër i jashtëm nuk do të gëzojë prioritet mbi huan me anë të një barre të krijuar më pas mbi asetet qeveritare. Për këtë qëllim, Huamarrësi merr përsipër që, nëse Fondi nuk bie dakord ndryshe, nëse do të krijohet një barrë mbi asetet e Huamarrësit si garanci për këtë borxh të jashtëm, kjo barrë *ipso facto* do të sigurojë edhe



proporcionalisht pagesën e principalit dhe interesit dhe tarifa të tjera mbi huan, dhe se në krijimin e kësaj barre, nuk do të merret asnjë masë e shprehur për këtë qëllim, megjithatë, me kusht që dispozitat e mësipërme të këtij seksioni të mos zbatohen për:

a) asnjë barrë të krijuar mbi pronën në kohën e blerjes së saj vetëm si garanci për pagesën e çmimit të blerjes së kësaj prone;

b) asnjë barrë mbi mallrat tregtare për të garantuar maturimin e një borxhi jo më shumë se një vit pas datës në të cilën është shkaktuar fillimisht dhe që duhet të paguhet nga të ardhurat e shitjes së këtyre mallrave tregtare; ose

c) asnjë barrë që lind gjatë ushtrimit të zakonshëm të transaksioneve bankare dhe garantimit të maturitetit të një borxhi jo më shumë se një vit pas datës së tij.

15. Principali dhe interesi mbi huan dhe të gjitha tarifat e tjera paguhen pa zbritje dhe janë të lira nga çdo taksë në fuqi sipas ligjeve të Huamarrësit.

16. Kjo Marrëveshje është e lirë nga taksat, tarifat dhe detyrimet e çdo natyre që mund të vendosen sipas ligjeve në fuqi në vendin e Huamarrësit në ose në lidhje me ekzekutimin, dorëzimin ose regjistrimin e tij, dhe Huamarrësi paguan ose merr masa për pagimin e të gjitha taksave, tarifave dhe detyrimeve, nëse ka, të vendosura sipas ligjeve në fuqi në çdo vend në të cilin është e pagueshme monedha e huas.

17. Principali dhe interesi, si dhe tarifat e tjera mbi huan paguhen të lira nga të gjitha detyrimet e vendosura sipas ligjeve në fuqi në vendin e Huamarrësit.

18. Huamarrësi dhe/ose Përfituesi garantojnë ose marrin masa për të garantuar që të gjitha mallrat e financuara nga të ardhurat e huas të sigurohen nga një prej kompanive të aprovuara të sigurimeve, kundër të gjitha rreziqeve në lidhje me blerjen, importimin e mallrave në territoret e Huamarrësit dhe dorëzimin e tyre në sheshin e projektit, dhe për ato shuma që janë të pajtueshme me praktikën e qëndrueshme tregtare. Kjo garanci do të jetë e pagueshme në monedhën në të cilën mallrat e siguruara janë blerë ose në monedhë lirisht të konvertueshme.

19. Huamarrësi merr të gjitha masat ose ndihmon për marrjen e të gjitha masave që do të jenë të nevojshme nga ana e tij për ekzekutimin e projektit dhe nuk merr ose nuk lejon marrjen e asnjë mase që do të pengonte ose ndërhynte në ekzekutimin ose operimin e projektit ose realizimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

20. Të gjitha dokumentet e Fondit, të dhënat, korrespondenca dhe materiale të ngjashme, konsiderohen nga Huamarrësi si çështje konfidenciale. Huamarrësi i jep Fondit imunitet të plotë nga censurimi dhe inspektimi i publikimeve.

21. Të gjitha asetet dhe të ardhurat e Fondit lehtësohen nga shtetëzimi, konfiskimi dhe sekuestrimi.

Neni 5

Anulimi dhe pezullimi

1. Me anë të një njoftimi për Fondin, Huamarrësi mund të anulojë çdo shumë të huas që Huamarrësi nuk ka tërhequr përpara dhënies së këtij njoftimi, me përjashtim të rastit kur Huamarrësi nuk mund ta anulojë këtë shumë të huas, në lidhje me të cilën Fondi ka bërë një zotim të veçantë sipas seksionit 2 të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Nëse ka ndodhur dhe vazhdon ndonjë prej rasteve të mëposhtme, me anë të një njoftimi për Huamarrësin, Fondi mund të pezullojë tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga huaja:

a) Kur ka ndodhur mosplotësim i plotë ose i pjesshëm i pagesës së principalit, ose interesit, ose i çdo pagese tjetër të kërkuar sipas kësaj Marrëveshjeje, ose çdo marrëveshjeje tjetër huaje ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit;

b) Kur ka ndodhur një mosplotësim i ndonjë zotimi apo marrëveshjeje tjetër nga ana e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

c) Kur Fondi ka pezulluar tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje sipas ndonjë marrëveshjeje tjetër huaje ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit për shkak të një mosplotësimi detyrimesh nga ana e Huamarrësit;

d) Kur ka lindur një situatë e jashtëzakonshme, e cila bën të pamundur që Huamarrësi të jetë i aftë të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje. Çdo rast i tillë që mund të ketë ndodhur pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, do të ketë të njëjtin ndikim që do të kishte pasur nëse do të kishte ndodhur pas tij. E drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje sipas huas do të vazhdojë të pezullohet tërësisht ose pjesërisht, sipas rastit, derisa rasti ose rastet që shkaktuan këtë pezullim do të kenë pushuar së ekzistuari ose derisa Fondi të ketë njoftuar Huamarrësin se e drejta për të bërë tërheqje është rivendosur, megjithatë, me kusht që në rastin e një njoftimi rivendosjeje, e drejta për bërjen e tërheqjeve do të rivendoset vetëm në masën dhe në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë njoftim, dhe asnjë njoftim i tillë nuk do të cenojë ose dëmtojë të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të Fondit në lidhje me çdo rast tjetër të mëtejshëm të përshkruar në këtë seksion.

3. Nëse ndonjë rast i përcaktuar në paragrafin “a” të seksionit pararendës do të ketë ndodhur dhe vazhdon për një periudhë prej gjashtëdhjetë ditësh, pasi njoftimi përkatës të jetë dhënë nga Fondi për Huamarrësin, ose nëse ndonjë rast i përcaktuar në paragrafët “b”, “c” dhe “d” të seksionit të lartpërmendur do të ketë ndodhur dhe do të ketë vazhduar për një periudhë prej nëntëdhjetë ditësh pasi njoftimi për këtë të jetë dhënë nga Fondi për Huamarrësin, atëherë në çdo kohë të mëtejshme gjatë vazhdimin të tij, Fondi, sipas zgjedhjes së vet, mund të shpallë principalin e huas të kërkueshëm dhe të pagueshëm në mënyrë të menjëhershme; dhe pas kësaj deklarate ky principal do të bëhet menjëherë i kërkueshëm dhe i pagueshëm, pavarësisht nga ndonjë element në kundërshtim me këtë Marrëveshje.

4. Nëse: a) e drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga huaja do të jetë pezulluar në lidhje me çdo shumë të saj për një periudhë të vazhdueshme prej tridhjetë ditësh, ose b) deri në datën e përcaktuar në seksionin 8 të nenit 3 si data e mbylljes, një shumë e huas do të mbetet e patërhequr, Fondi, me anë të një njoftimi drejtuar Huamarrësit, mund t’i japë fund të drejtës së Huamarrësit për të bërë tërheqje në lidhje me këtë shumë. Pas dhënies së këtij njoftimi, kjo shumë e huas do të anulohet.

5. Asnjë anulim ose pezullim nga Fondi nuk zbatohet për shumën që u nënshtrohen ndonjë zotimi të veçantë të bërë nga Fondi sipas seksionit 2 të nenit 3, përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht në këtë zotim.

6. Çdo anulim zbatohet proporcionalisht për disa maturitete të shumës së principalit të huas, siç përcaktohet në skedulin e amortizimit të kësaj Marrëveshjeje.

7. Pavarësisht nga ndonjë anulim ose pezullim, të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të jenë në fuqi dhe efekt të plotë, përveç kur parashikohet shprehimisht në këtë nen.

Neni 6

Zbatueshmëria e kësaj Marrëveshjeje; pamundësia për ushtrimin e të drejtave; arbitrazhi

1. Të drejtat dhe detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë të vlefshme dhe të zbatueshme në përputhje me kushtet e tyre, pavarësisht nga ndonjë ligj i brendshëm në kundërshtim. As Huamarrësi, as Fondi nuk janë të autorizuar, në asnjë rrethanë, të shpallin pretendime që ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme ose e pazbatueshme në asnjë lloj rrethane.

2. Pamundësia për ushtrimin e ndonjë të drejte ose kompetence të dhënë për secilën palë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk e pengon atë ta ushtrojë këtë të drejtë ose kompetencë në çdo kohë të mëtejshme dhe nuk interpretohet si heqje dorë prej saj. Në mënyrë të ngjashme, asnjë lëshim i treguar nga një palë në lidhje me ndonjë mosplotësim detyrimesh nga pala tjetër, e përjashton atë që të drejtohet më tej për çdo veprim në dispozicion të saj sipas kësaj Marrëveshjeje në lidhje me këtë mosplotësim detyrimesh.

3. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo pretendim nga një palë kundër tjetrës që lind sipas kësaj Marrëveshjeje, përfundon me anë të një marrëveshjeje miqësore. Nëse



nuk është arritur asnjë marrëveshje e tillë, mosmarrëveshja ose pretendimi referohen për zgjidhje nga një Gjykatë Arbitrazhi, në përputhje me dispozitat e mëposhtme të këtij neni.

4. a) Gjykata e Arbitrazhit përbëhet nga tre arbitra ku një caktohet nga Huamarrësi dhe një nga Fondi. Arbitri i tretë (më poshtë i quajtur Gjyqtari i Arbitrazhit) caktohet me marrëveshje ndërmjet palëve. Nëse të dyja palët nuk kanë rënë dakord brenda 60 ditësh nga fillimi i procedimeve të arbitrazhit për Gjyqtarin e Arbitrazhit, ky i fundit do të caktohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ligës Arabe ose nga çdo organizatë tjetër ndërkombëtare të pranueshme nga të dyja palët. Nëse një palë nuk ka mundur të caktojë arbitrin e vet brenda 30 ditësh nga fillimi i procedimeve të arbitrazhit, Sekretari i Përgjithshëm i Ligës Arabe ose organizata ndërkombëtare do ta caktojë atë, me kërkesë të palës tjetër. Në rast të heqjes dorë, vdekjes ose paaftësisë për të vepruar të ndonjë arbitri, një pasardhës caktohet në të njëjtën mënyrë në të cilën është zgjedhur arbitri i parë.

b) Procedimet e arbitrazhit mund të fillohen nga çdo palë që i jep tjetrës njoftim, i cili përmban një deklaratë të qartë të natyrës së mosmarrëveshjes ose pretendimit që do t'i paraqitet arbitrazhit, natyrën dhe masën e kompensimit të kërkuar, dhe emrin e arbitrit të caktuar nga pala që fillon procedimet e arbitrazhit. Brenda tridhjetë ditësh pas dhënies së këtij njoftimi, pala kundërshtarë do të njoftojë tjetrën për emrin e arbitrit të vet. Gjykata e Arbitrazhit mblidhet në atë kohë dhe vend që caktohet nga Gjyqtari i Arbitrazhit. Më pas, Gjykata e Arbitrazhit cakton vendin dhe kohën kur do të mblidhet.

c) Gjykata e Arbitrazhit përcakton procedurën e vet, në mënyrë që secilës palë t'i ofrohet një seancë e drejtë. Gjykata e Arbitrazhit mund të përcaktojë çështjet para saj ose në prani të palëve, ose në mungesë. Të gjitha vendimet e saj janë me shumicë votash. Vendimi jepet me shkrim dhe nënshkruhet të paktën nga një shumicë e Gjykatës së Arbitrazhit. Një kopje e nënshkruar e vendimit i dërgohet secilës palë. Çdo vendim i tillë i dhënë në përputhje me dispozitat e këtij neni, është i formës së prerë dhe detyrues për palët e kësaj Marrëveshjeje. Çdo palë i përmbahet dhe pajtohet me këtë vendim të dhënë nga Gjykata e Arbitrazhit.

d) Gjykata e Arbitrazhit zbaton parimet e përbashkëta sipas ligjeve aktuale të Huamarrësit dhe shtetit të Emirateve të Bashkuara Arabe, si dhe në bazë të parimeve të drejtësisë dhe ndërgjegjes së mirë.

e) Çdo palë paguan shpenzimet e saj në procedimet e arbitrazhit, duke përfshirë tarifat e arbitrit të caktuar prej saj. Shpenzimet e Gjykatës së Arbitrazhit dhe tarifat e Gjyqtarit të Arbitrazhit ndahen midis dhe përballohen në mënyrë të barabartë nga palët. Asnjë çështje në lidhje me ndarjen e shpenzimeve të Gjykatës së Arbitrazhit ose procedura për pagesën e këtyre shpenzimeve nuk përcaktohet nga Gjykata e Arbitrazhit.

5. Dispozitat për arbitrazhin, të parashtruara në seksionin e mëparshëm, zëvendësojnë çdo procedurë tjetër për përcaktimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo pretendimi nga një palë kundër palës tjetër që lind sipas saj.

6. Dërgimi i çdo njoftimi ose kryerja e çdo procesi në lidhje me ndonjë procedim sipas këtij neni, mund të bëhet në të njëjtën mënyrë që parashikohet në seksionin 1 të nenit 7.

Neni 7

Dispozita të ndryshme

1. Çdo njoftim ose kërkesë, e kërkuar dhe e lejuar, të jepet ose të bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë me shkrim. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në seksionin 3 të nenit 8, ky njoftim ose kjo kërkesë do të konsiderohen të jenë dhënë ose bërë sipas rregullave kur i dërgohen dorazi, me postë ose telegram, palës së cilës kërkohet ose lejohet t'i jepet ose bëhet, në adresën e kësaj pale të përcaktuar në këtë Marrëveshje ose në çdo adresë tjetër që kjo palë do të ketë përcaktuar me anë të një njoftimi drejtuar palës tjetër.

2. Huamarrësi i jep Fondit prova të mjaftueshme të autoritetit të personit ose personave, të cilët do të nënshkruajnë kërkesat e parashikuara në nenin 3 ose që në emër të Huamarrësit, do të marrin çdo masë tjetër ose do të ekzekutojnë çdo dokument tjetër të kërkuar ose që lejohet të merret ose ekzekutohet

nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe modelin e nënshkrimit të vërtetuar të secilit prej këtyre personave.

3. Çdo veprim që kërkohet ose lejohet të bëhet dhe çdo dokument që kërkohet ose lejohet të ekzekutohet sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit, mund të bëhet ose ekzekutohet nga Ministri i Financave i Huamarrësit ose çdo person i autorizuar me shkrim nga ai sipas kësaj Marrëveshjeje. Çdo ndryshim ose zgjerim i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje mund të miratohet në emër të Huamarrësit me anë të një dokumenti me shkrim të nënshkruar në emër të Huamarrësit nga përfaqësuesi i tij i lartpërmendur ose çdo person i autorizuar me shkrim nga ai sipas kësaj marrëveshjeje, me kusht që sipas mendimit të këtij përfaqësuesi, ky ndryshim ose zgjerim të jetë i arsyeshëm sipas rrethanave dhe të mos rrisë dukshëm detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje. Fondi mund të pranojë ekzekutimin nga ky përfaqësues ose person tjetër të çdo instrumenti të tillë si provë përfundimtare, që sipas mendimit të këtij përfaqësuesi, çdo ndryshim ose zgjerim i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje të kryera nga ky instrument është i arsyeshëm sipas rrethanave dhe nuk do të rrisë dukshëm detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

4. Çdo marrëveshje e veçantë e shkëmbyer ndërmjet palëve në lidhje me ose sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë detyruese për të njëjtin efekt sikur të përfshiheshin në të.

5. Gjuha mbizotëruese, sipas të cilës duhet të interpretohet kjo marrëveshje, është gjuha arabe.

Neni 8

Data e hyrjes në fuqi, përfundimi

1. Kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi derisa Fondit t'i jenë dhënë prova të mjaftueshme se ekzekutimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit janë autorizuar dhe miratuar sipas rregullave nga i gjithë veprimi kushtetues i nevojshëm.

2. Si pjesë e provave që do të jepen sipas seksionit pararendës, Huamarrësi i jep Fondit një opinion të një autoriteti kompetent që tregon se kjo Marrëveshje është autorizuar ose miratuar sipas rregullave, dhe është ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit, dhe përbën një detyrim ligjor dhe detyrues të Huamarrësit në përputhje me kushtet e saj.

3. Nëse Fondi bindet me provat e dhëna nga Huamarrësi në lidhje me efektin detyrues të kësaj Marrëveshjeje, Fondi i dërgon Huamarrësit njoftim me anë të një shkrese zyrtare për pranimin nga ana e tij të provave të kërkuara nga seksioni 1 i këtij neni. Kjo Marrëveshje do të jetë efektive dhe do të hyjë në fuqi në datën në të cilën është dërguar kjo shkresë.

4. Nëse të gjitha aktet që kërkohen të kryhen sipas seksionit 1 të këtij neni nuk janë realizuar përpara 120 ditëve pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje ose një date tjetër që bihet dakord nga Fondi dhe Huamarrësi në çdo kohë më pas, Fondi, me zgjedhjen e vet, mund t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje me anë të njoftimit drejtuar Huamarrësit. Pas dhënies së këtij njoftimi, kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas saj do të përfundojnë menjëherë.

5. Nëse dhe kur e tërë shuma e principalit të huas dhe i gjithë interesi dhe tarifat e tjera që do të jenë shtuar mbi huan do të jenë paguar, kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas saj, do të përfundojnë menjëherë.

Neni 9

Përkufizimet

1. Përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme sa herë që përdoren në këtë Marrëveshje ose skedul të saj:

a) Termi "Projekt" nënkupton projektin ose projektet, ose programin ose programet për të cilat është dhënë Huaja, siç përshkruhet në skedulën 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe siç ndryshohet përshkrimi i saj herë pas here me marrëveshje ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit.

b) Termi "Mallra" nënkupton pajisjet, furnizimet dhe shërbimet që kërkohen për projektin. Sa herë që i referohet koston së mallrave, kjo kosto konsiderohet të përfshijë koston e importimit të këtyre mallrave në territoret e Huamarrësit.



Adresat e mëposhtme caktohen për qëllime të nenit 7 të seksionit 1:

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave

1 Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Shqipëri

Tel.: +355 4 2228405

Faks: +355 4 229200

Për Fondin :

Abu Dhabi Fund for Development

P.O.Box 814, Abu Dhabi, U.A.E

Tel.: 971-2-6677100

Faks: 971-2-6677070

Teleks: 22287 FUND EM

Në dëshmi të kësaj, palët e kësaj Marrëveshjeje, që veprojnë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë nënshkruar dhe dorëzuar këtë Marrëveshje në emrin e tyre përkatës në Abu Dhabi në tri kopje, ku secila konsiderohet një origjinal dhe ku të gjitha janë për një efekt të njëjtë dhe të vetëm, në ditën dhe vitin e shkruar fillimisht më sipër.

Për Huamarrësin

Ministri i Financave

Ridvan Bode

SKEDULI 1 SKEDULI I AMORTIZIMIT

Projekti i rrugës Tiranë-Elbasan
Republika e Shqipërisë

Numri i shlyerjeve	Data e kësteve të pagueshme	Shuma totale e kësteve të pagueshme AED
1	30.9.2014	7,652,000.00
2	30.3.2015	7,652,000.00
3	30.9.2015	7,652,000.00
4	30.3.2016	7,652,000.00
5	30.9.2016	7,652,000.00
6	30.3.2017	7,652,000.00
7	30.9.2017	7,652,000.00
8	30.3.2018	7,652,000.00
9	30.9.2018	7,652,000.00
10	30.3.2019	7,652,000.00
11	30.9.2019	7,652,000.00
12	30.3.2020	7,652,000.00
13	30.9.2020	7,652,000.00
14	30.3.2021	7,652,000.00
15	30.9.2021	7,652,000.00
16	30.3.2022	7,652,000.00
17	30.9.2022	7,652,000.00
18	30.3.2023	7,652,000.00
19	30.9.2023	7,652,000.00
20	30.3.2024	7,652,000.00
21	30.9.2024	7,652,000.00
22	30.3.2025	7,652,000.00
23	30.9.2025	7,652,000.00
24	30.3.2026	7,654,000.00
TOTALI		183,650,000.00
AED Vetëm njëqind e tetëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë.		

SKEDULI 2 OBJEKTIVAT DHE PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivat e projektit

Projekti synon të lehtësojë lëvizjen e transportit midis Tiranës, kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë, dhe Elbasanit, një prej qendrave më të rëndësishme ekonomike të qytetit. Gjithashtu, projekti do të zvogëlojë kohën e udhëtimit midis dy qyteteve dhe numrin e aksidenteve, dhe do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik.

Përshkrimi i projektit

Projekti përbëhet nga ndërtimi i një rruge automjetesh me dy drejtime (dy korsit për secilën rrugë), në mënyrë që të lejojë lëvizjen pa probleme në të dyja drejtimet. Gjatësia e rrugës është rreth 27 km dhe gjerësia e saj është rreth 28.2 dhe përfshin ndërtimin e dy tuneleve me kapacitet të dy korsive për tunel të një gjatësie mesatare prej rreth 2.2 km. Projekti është ndarë në seksionet e mëposhtme:

- Seksioni 1: rruga nga Tirana për në hyrjen e tunelit (13 km).
- Seksioni 2: tunelet dykalimëshe me gjatësi 2.2 dhe 3.2 km.
- Seksioni 3: rruga nga tunelet për në Elbasan 11.8 km.

LISTA E MALLRAVE

Përshkrimi	Shuma AED	Përqindja %
Seksioni 1: (Rruga: Tiranë-Tunel-13 km)	102,844,000	25 %
Seksioni 3: (Rruga: Tunel-Elbasan-11.8 km)	55,095,000	16 %
Seksioni 1: Shërbim konsulence, supervizion	3,673,000	50 %
Seksioni 3: Shërbim konsulence, supervizion	3,673,000	50 %
Kontigjencë 10%	18,365,000	
Totali	183,650,000	

LIGJ Nr. 10/2012

PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË LIGJIN NR.9136, DATË 11.9.2003 “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 7 Regjistrimi

Personat juridikë dhe fizikë ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare vetëm pas regjistrimit të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Dy ditë pune pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, personi juridik dhe fizik duhet të deklarojë në organin tatimor listën e të punësuarve, me pagën përkatëse, përfshirë dhe listën e punonjësve të papaguar të familjes së personit fizik mbi 16 vjeç, me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht.

Organizatat jofitimprurëse, entet shtetërore, personat “i vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi ambulant”, si dhe “kryefamiljari, që punëson persona si punëtorë shtëpie” regjistrohen në administratën tatimore, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Neni 2

Në fund të nenit 8 shtohen fjalët “të miratuar për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”.

Neni 3

Në nenin 9 pika 1, pas fjalës “minimale” shtohen fjalët “të miratuar për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”.

Neni 4

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Detyrimi për të deklaruar

1. Personi i detyruar për të paguar kontribute, për çdo periudhë, duhet të deklarojë në organet tatimore të dhënat për kontributet në total dhe për çdo individ.

2. Deklarata për kontributet e subjektit duhet të përmbajë shumën e kontributeve, të sigurimeve shoqërore, të sigurimeve shëndetësore, për t'u paguar, numrin e kontribuesve.

3. Personat që janë të detyruar të paguajnë kontribute deklarojnë në organin tatimor të dhënat, sipas formatit të listëpagesës, ku, përveç të tjerave, shënohet për çdo person emri e mbiemri, numri personal, paga, shuma e kontributeve të sigurimeve shoqërore, të sigurimeve shëndetësore, si dhe e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për t'u paguar.

4. Forma, përmbajtja dhe rregullat e deklarimit, në organet tatimore, të kontributeve dhe ndryshimit të numrit të punonjësve, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

Neni 5

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalia e parë riformulohet si më poshtë:

“Deklarimet e parashikuara në nenin 10 dhe pagesa e kontributeve bëhen në afatet e mëposhtme:”.

2. Shkronja “b” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“b) nga personat fizikë, përjashtuar personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Deklarata në këtë rast do të përfshijë personat e vetëpunësuar, punonjësit e papaguar të familjes si dhe të punësuarit;”.

3. Pika 2 shfuqizohet.

4. Pika 3 riformulohet si më poshtë:

“3. Personi juridik e fizik është i detyruar të deklarojë zyrtarisht, në organin tatimor, çdo punonjës që fillon punë për herë të parë te subjekti apo të punësuar rishtazi pranë tij, të paktën një ditë kalendrike përpara fillimit të punës.

Të larguarit nga puna subjektet duhet t'i deklarojnë zyrtarisht në organin tatimor brenda 10 ditëve kalendrike nga data e largimit.”.

Neni 6

Në nenin 13, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Nëse si rezultat i një kontrolli, konstatimi apo vlerësimi shuma e kontributeve të paguara e tejkalon shumën e llogaritur të detyrimit për kontributin, organi përkatës rimbursen diferencën, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

Neni 7

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

Mbajtja e regjistrimeve

Punëdhënësi duhet të mbajë regjistrime për periudhën e marrëdhënieve të punës dhe shumat e paguara në para ose si përfitime në natyrë, për çdo punëmarrës, sipas përcaktimeve të bëra në Kodin e Punës dhe me vendim të Këshillit të Ministrave. Këto regjistrime u vihen në dispozicion punonjësve të autorizuar të administratës tatimore sa herë që kërkohet prej tyre.

Tatimpaguesi duhet të vendosë në listëpagesë numrin personal të çdo punonjësi. Tatimpaguesi i jep çdo punëmarrësi një formular me të dhënat, të ndara sipas muajve, për pagën, kontributet dhe tatimin e paguar gjatë periudhës së punësimit brenda një viti kalendarik.”.

Neni 8

Neni 17 shfuqizohet.

Neni 9

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

Vlerësimi

Kur organet tatimore zbulojnë se kontributet nuk janë llogaritur e paguar në masën e duhur, bëjnë vlerësime. Për vlerësimet dhe mbledhjen e detyrimeve për kontributet, kamatëvonesat dhe gjobat, zbatojnë rregullat e përcaktuara në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”. përjashtuar afatin e parashkrimit të detyrimeve. Radha e pagesës së detyrimeve, që lidhen me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të paguara pjesërisht, është:

- a) kontributet e sigurimeve shëndetësore;
- b) kontributet e sigurimeve shoqërore të punëmarrësit;
- c) kontributet e sigurimit suplementar;
- ç) kontributet e sigurimeve shoqërore të punëdhënësit;
- d) kostot administrative;
- dh) gjobat;
- e) kamatëvonesat.”.



Neni 10

Kudo në ligj, fjalët “ligjin nr.8560, datë 22.12.1999” zëvendësohen me fjalët “ligjin nr.9920, datë 19.5.2008” dhe fjala “interesa” zëvendësohet me fjalën “kamatëvonesa”.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 9.2.2012

**Shpallur me dekretin nr.7290, datë 21.2.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

**LIGJ
Nr. 11/2012**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8402, DATË 10.9.1998 “PËR
KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 12, pas paragrafit të fundit shtohen paragrafët: i shtatë, i tetë, i nëntë dhe i dhjetë me këtë përmbajtje:

“Për objektet e ndërtuara mbi bazën e lejeve të ndërtimit të miratuara para fillimit me efekte të plota të ligjit nr. 10 119 datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, në rastet kur subjektet ndërtuese/investitori nuk kanë emëruar kolaudatorin, pa shkak të vlefshëm ligjor, brenda 3 vjetëve nga përfundimi i afatit të lejes së ndërtimit, ose këto subjekte:

- a) figurojnë të çregjistruara;
- b) kanë falimentuar;
- c) janë likuiduar;
- ç) janë joaktive;

atëherë njësia e qeverisjes vendore cakton një kolaudator të licencuar për përgatitjen e procesverbalit të kolaudimit. Procesverbali nënshkruhet nga një përfaqësues i njësive së qeverisjes vendore, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe kolaudatori.

Në rastet kur mungon dokumentacioni i mbikëqyrjes së punimeve, apo mbikëqyrësi mungon për të njëjtat arsye të përcaktuara në paragrafin e mësipërm për investitorin/ndërtuesin, njësia e qeverisjes vendore cakton një grup ekspertësh konstruktorë për hartimin e raportit teknik për ndërtimin e objektit. Procesverbali i kolaudimit të punimeve, në këtë rast, do të hartohet mbi bazën e këtij raporti dhe do të nënshkruhet nga grupi i ekspertëve konstruktorë, kolaudatori dhe një përfaqësues i qeverisjes vendore.

Për rastet kur ndërtimi i objekteve ka përfunduar dhe nuk janë kryer aktet e kontrollit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ngarkohet njësia e qeverisjes vendore për kryerjen e një akti përmbledhës për të gjitha fazat e kontrollit.

Shpenzimet për kolaudatorin dhe grupin e ekspertëve konstruktorë, të caktuar nga njësia e qeverisjes vendore, përballohen nga vetë ajo.”.

Neni 2

Në nenin 12/1 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Kudo në nen fjala “provizor” zëvendësohet me fjalën “i përkohshëm”.

2. Paragrafi i parë riformulohet si më poshtë:

“Autoriteti përkatës i planifikimit dërgon zyrtarisht në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme:

a) kërkesën për regjistrimin e lejes së ndërtimit dhe ose lejen e zhvillimit të lëshuar nga autoriteti përkatës i planifikimit, brenda 10 ditëve nga data e pajisjes së investitorit ose pronarit me këtë leje;

b) kërkesën për regjistrimin e përkohshëm të karabinasë në fazën e përfundimit të saj, brenda 10 ditëve nga data e lëshimit të certifikatës përkatëse.”.

3. Në paragrafin e dytë, rreshti i parë, fjala “i përkohshëm” hiqet.

4. Në fund të paragrafit të fundit shtohen fjalët “dhe legjislacionit në fuqi”.

Neni 3

Në nenin 13 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fillim të paragrafit të dytë fjalët “Me kërkesën e zotëruesit të sheshit të ndërtimit” hiqen.

2. Në fund të nenit shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën regjistrimin e objektit, në bazë të kërkesës së njësisë së qeverisjes vendore, sipas paragrafëve të shtatë, të tetë, të nëntë dhe të dhjetë të nenit 12 të këtij ligji, për pronarët e truallit dhe subjektet, me të cilat investitori ka pasur aktmarrëveshje ose kontratë sipërmarrjeje.

Njësia e qeverisjes vendore është e detyruar që të depozitojë në ZRPP lejen e shfrytëzimit jo më vonë se 60 ditë nga fillimi i procedurës, sipas paragrafëve të shtatë, të tetë, të nëntë dhe të dhjetë të nenit 12 të këtij ligji.”.

Neni 4

Kudo në ligj termat “leja për sheshin e ndërtimit” dhe “leja e shfrytëzimit ose e banimit të objektit” zëvendësohen, përkatësisht, me termat “leja e zhvillimit” dhe “leja e përdorimit”.

Kudo në ligj fjalët “seksioni ose zyra përkatëse e urbanistikës” zëvendësohen me fjalët “autoriteti përkatës i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.2.2012

**Shpallur me dekretin nr.7291, datë 21.2.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 27.2.2012
Doli nga shtypi më 29.2.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 38 lekë